



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

Nr. 9191/prot.

Elbasan, më 26.04.2021

3

VENDIM

Nr. 11 datë 26/04/2021

“PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT
“ALEKSANDËR XHUVANI” NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKILIT TË DYTË, PËR
VITIN AKADEMIK 2021-2022”

Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 7, neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në Statutin e UE-së, neni 9, germa “h”, si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të UE-së, Senati Akademik i UE-së më datë 26.04.2021.

V E N D O S I :

1. Të miratojë kuota e pranimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2021-2022 (tabela 2 bashkëlidhur), si më poshtë:

- a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: 458 kuota.
- b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: 26 kuota.
- c) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë shtetas të huaj: 0 kuota.
- d) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe ballkano egjiptianë): 7 kuota.
- e) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: 3 kuota
- f) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: 104 kuota.

2. Të miratojë kuota e pranimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani” në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2021-2022, (tabela 3 bashkëlidhur), si më poshtë:
- a) Kuota e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **1059 kuota**.
 - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **10 kuota**.
 - c) Kuota e pranimit për kandidatë studentë shtetas të huaj: **0 kuota**.
 - d) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe ballkano egjiptianë): **13 kuota**.
 - e) Kuota e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **11 kuota**
 - f) Kuota e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **136 kuota**.
3. Kuota e paralizuarra të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e; 1/f dhe të pikave 2/b, 2/c, 2d ,2/e, dhe 2/f do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njëjste kryesore të UE-së.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Skender TOPI



